

Nr. 791-792 -Regj.

Tiranë më 07. 12. 2016

Lënda : Rikërkohe kryerja shënimi i bllokimit të aktiveve që ka pala debitore

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Të nderuar zotërinj !

Ne lidhje me ekzekutimin e Urdhërave të Ekzekutimit **nr.10239/38 Akti, datë 11.01.2016 dhe nr.10238, datë 29.12.2015** të leshuar nga Gj.Rr.Gj.Tirane për titujt ekzekutiv Kontrata Kredie Banke, në ngarkim të pales debitore dhe asaj dorezanese, si dhe urdhërimit tonë të datës 09.11.2016, ju sqarojmë se :

Shoqëria përmbarimore **"Power & Justice" (P&J) sh.p.k** Në bazë të Nenit 527 e vijues të K.Pr.Civile si dhe nenit 46 të ligjit nr.10031 datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat" ka depozituar pranë institucionit tuaj shkresën nr. 791- 792 Rregjistri ku në të cilin kemi kërkuar vendosjen e shenimit në Regjistrat tuaj, për bllokimin e aktiveve të pales debitore **shoqëria Shoqëria "MET-PLAS" sh.p.k me NIPT J 62223003 D**, me qëllim mos tjetërsimin e tyre. Aktivete shoqërise do të qëndrojnë të bllokuara deri në shlyerjen e plote të detyrimit.

Gjithashtu ju kemi kërkuar që të benit dhe verifikimin përkatës nëse në QKB pala dorezanese Sokol Ali Korbi, i datëlindjes 25.06.1953, Roland Agim Istrefi i datëlindjes 07.02.1969, Agim Nazmi Istrefi i datëlindjes 22.02.1943 figurojnë që të kenë kapitale ose aksione në shoqëri të tjera.

Nga verifikimet e kryera në Regjistrin Elektronik na rezultoi se nga ana e institucionit tuaj nuk është pasqyruar shënimi i masës së sekuestros si dhe nuk është kthyer përgjigje për atë që ne kemi kërkuar në shkresën tonë të datës 09.11.2016. Ky veprim sjelle si pasoje pengimin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Në këto kushte jemi të detyruar të Riurdhërojmë kryerjen e veprimeve të kërkuar në shkresën tonë të datës 09.11.2016 duke vendosur shënimin e masës bllokimit të aktiveve të pales debitore **shoqëria Shoqëria "MET-PLAS" sh.p.k me NIPT J 62223003 D** me qëllim mos tjetërsimin e tyre. Aktivete shoqërise do të qëndrojnë të bllokuara deri në shlyerjen e plote të detyrimit.

Gjithashtu institucioni juaj duhet të bëjë dhe verifikimin përkatës nëse në QKB pala dorezanese Sokol Ali Korbi, i datëlindjes 25.06.1953, Roland Agim Istrefi i datëlindjes 07.02.1969, Agim Nazmi Istrefi i datëlindjes 22.02.1943 **figurojnë që të kenë kapitale ose aksione në shoqëri të tjera.**

VEPRIMI I JUAJ DUHET TË KRYET BRËNDA AFATIT LIGJOR SI DHE DUHET TË KTHEHET PËRGJIGJE PO MENJËHER
Për personat qe behen pengese ne zbatimin e ketij urdheri do te merren te gjitha masat e
parashikuara ne nenin 606 e vijues te K.Pr.Civile.


Duke ju falenderuar per mirekuptimin

*Shenim : Bashkelidhur fotokopjet e e urdhereses se shjelle ne date 09.11.2016 si dhe Flete
Porosise qe verteton marjen e shkreses ne date 10.11.2016*

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ILIR S. D
Ilir S. DERVISHAJ





Nr. 791-792-Regj.

Tirane me 09. 11. 2016

Lenda



Kerkohe te kryet shenimi i bllokimit te aktiveve qe ka pala debitore

QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT

TIRANE

Pranë shërbimit përbarimor "Power & Justice" (P&J) sh.p.k me kërkesë të palës kreditore janë paraqitur për ekzekutim titujt ekzekutiv me palë:

Kreditor : Raiffeisen Bank sh.a

Debitor : Sh " MET PLAST " sh.p.k

Dorëzanës : Sokol Korbi, Roland Istrefi, Agim Istrefi

Me objekt : Kthim Shume (Kredi Bankare)

Une përbaruesi gjyqesor Ilir Dervishaj pasi shqyrtova materialin e dosjes përbarimore

KONSTATOVA

Në titujt ekzekutiv Kontrata Kredie Bankare nr.4679 rep, nr.2095 kol, datë 08.12.2014 dhe Kontratë Kredie Bankare nr.4680 rep, nr.2096 kol, datë 10.12.2014, është përcaktuar detyrimi i palës debitore Shoqëria " MET PLAST " sh.p.k dhe palës dorëzanëse Sokol Korbi, Roland Istrefi, Agim Istrefi të paguajë në favor të palës kreditore Raiffeisen Bank sh.a shumën e marrë hua së bashku me interesa në masën prej 378,692 Euro dhe 253,509-Euro. Për këta tituj ekzekutiv nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë lëshuar dhe Urdhërat e Ekzekutimit nr.10239/38 Akti, datë 11.01.2016 dhe nr.10238, datë 29.12.2015 si dhe pala kreditore ka kërkuar pranë shoqërisë sone ekzekutimin e tyre.

Me fillimin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv në bazë të nenit 517 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është njoftuar pala debitore për të kryer ekzekutimin e titullit në mënyre vullnetare. Gjatë kësaj perjudhe pala debitore dhe ajo dorëzanëse ka marrë kontakt me palën kreditore Raiffeisen Bank sh.a dhe palët kanë rënë në marrëveshje për shlyerjen e detyrimit me këste. Pala kreditore Raiffeisen Bank me kërkesën nr.34957 prot, datë 22.09.2016 mberitur ne date 23.09.2016 ka kërkuar pezullimin e procedurës përbarimore. Kërkesa për pezullim të ekzekutimit është paraqitur në momentin që shërbimi përbarimor po përgatiste kalimin e ekzekutimit në mënyre të detyrueshme. Bazuar në ligjin procedurjal nga ana e shërbimit përbarimor është marrë vendimi i pezullimit. Pala kreditore, ka njoftuar shërbimion tone përbarimor se debitori nuk ka respektuar marrëveshjen, ka paraqitur kërkesën duke kërkuar ekzekutim urdhërin të ekzekutimit. Duke parë që titulli ekzekutiv është pezulluar në momentin e kalimit të titullit në ekzekutim të detyrueshme në kemi marrë vendimin e kalimit të ekzekutimit të titullit në mënyrë të detyrueshme dhe për këtë duhet të urdhërohet vendosja e masës së sekuestros mbi pasurinë e luajtëshme dhe të paluajtëshme të palës debitore dhe për këtë është e nevojshme të vendoset shenimi i bllokimit të aktiveve të shoqërisë debitore të regjistruara në Qendren Kombetare të Regjistrimit me qëllim mostjetersimin e tyre.

Per keto arsye :

Në bazë të Nenit 527 e vijues të K.Pr.Civile si dhe nenit 46 të ligjit nr.10031 date 11.12.2008 "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat".

URDHËROJMË

qendosjen e shenimit ne regjistrat tuaj, per bllokimin e aktiveve te pales debitore shoqeria shoqeria "MET-PLAS" sh.p.k me NIPT J 62223003 D, me qellim mostjetersimin e tyre. Aktivete shoqerise do te qendrojne te bllokuara deri ne shlyerjen e plote te detyrimit.

Gjithashtu ju duhet te beni dhe verifikim perkates nese ne QKB pala dorezanese Sokol Ali Korbi, i datelindjes 25.06.1953, Roland Agim Istrefi-i datelindjes 07.02.1969, Agim Nazmi Istrefi i datelindjes 22.02.1943 figurojne qe te kene kapitale ose aksione ne shoqeri te tjera Per veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor.

Per personat qe behen pengese ne zbatimin e ketij urdheri do te merren te gjitha masat e parashikuara ne nenin 598 e ne vijim te K.Pr.Civile.

Ky urdher u njoftohet paleve te cilat ne baze te nenit 610 te K.Pr.C kane te drejten e ankimit ne gjykafen e rrethit gjyqesor brenda Tirane 5 diteve nga dita e neserme e marjes dijeni.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin

Shenim : Bashkelidhur fotokopjet e Urdherit te Ekzekutimit

PERMBARUESI GJYQESOR

Hir S. DERVISHAJ



LETERE POROSITUR

Përmban : Letër - Lajmërimin Nr. 791-792 Regj, datë 08.11.2016
Dërguar : Sh "Power & Justice" shpk Bul "Gjergj Fishta", kulla 3.kat.2.nr.2 Tirane

Drejtuar : AKB
Përmban : Kërkesat e zënjës së mirë i bllokimit
e arkivës së kësaj qelie debitorë

Adresa : Tirane

LETERE POROSITUR

Me të cilën vërtetohet se leter lajmërimi i mësipërm është komunikuar personit të lartpërmëndur në datë 16.11.2016.

POSTIERI

MARRESI
[Signature]

[Signature]